



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal of Kacanik

01Nr. 060/01-22036/25
Kaçanik, 11.09.2025

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e **VIII (tetë)** e rregullt e Kuvendit të Komunës Kaçanik për vitin 2025 (Legjislatura e shtatë), mbajtur me 11.09.2025. Mbledhja u mbajt në katin e tretë të objektit të komunës, në sallën e kuvendit, në ora 11:00.

Nga përbërja e përgjithshme e Kuvendit të Komunës prej 27 anëtarëve, pjesëmarrës në mbledhje ishin 25 anëtarë. Në mbledhje mungoj Betim Shala dhe Besnik Salihu.

Nga Ekzekutivit i Komunës, në mbledhje morën pjesë: Kryetari i Komunës-Besim Ilazi, Nënkryetari i komunës-Sabedin Vishi, Drejtorët e drejtorive: Valdrin Dogani-DBF, Arian Teneqja-DSHPE, Qamil Stagova- DUKMM, Suhad Dullovi- DBPZHR. ndërkaq nga zyrtarët në kuadër të detyrave të punës: Fatlume Guri-Selimi, Bejtulla Dalloshi.

Mbledhja monitorohet përmes Teleprezencës nga Vjosa Ahmetaj- zyrtare në MAPL. Mbledhja ka transmetim të drejtpërdrejtë.

Mbledhjen e kryesoj, Kemal Murseli- Kryesues i Kuvendit

Procesmbajtës, Maviqe Murseli - Asistente e Kryesuesit të Kuvendit.

Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Murseli: Të nderuar pjesëmarrës, së pari iu përshëndes të gjithëve, iu dëshiroj mirëseardhje, konstatoj kuorumin, kushte pune me u mbajtur mbledhja ka, e hapi mbledhjen e VIII (tetë) të rregullt të Kuvendit të Komunës, data 11.09.2025, me këtë:

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;
2. Propozim Vendimi për Buxhetin e Komunës së Kaçanikut për vitin fiskal 2026 dhe vlerësimet për vitet 2027-2028;
3. Propozim Vendimi për miratimin e Planit Ndërkomunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave për rajonin e Gjilanit dhe Ferizajt (2025-2030);
4. Kërkesa e MMPHI dhe MAPL për rishqyrtimi e Rregullores për transport rrugor në territorin e komunës së Kaçanikut.

Lidhur me rendin e punës, e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë e shtrajmë në votim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës

Aprovoj

Rendin e punës prej 4 pikave.

1.Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;

Procesverbalin i mbledhjes se kaluar të KK u aprovua me 25 votë Për. Prezentë 25. Në sajë të kësaj del konstatimi se kuvendi i Komunës pa vërejtje e,

Aprovoj

**Procesverbalin e mbledhjes së VII (shtatë) të Kuvendit të Komunës, të datës 29.07.2025/
Lënda: 01Nr.060/01-16918/25.**

Pyetje dhe Kërkesa

znj. Arlinda Raka: Edhe vitin e kaluar kam ngritur shqetësimin për mungesën e asistentëve, sidomos në shkollën fillore “Emin Duraku”. Atëherë, edhe pse kishte vende të lira, u tha se nuk kishim kuadër. Si nënë, e di se çfarë duhet të thuhet si mungesë, prandaj kërkoj urgjentisht që të plotësohet numri i asistentëve, sepse kjo nuk është luks, por një e drejtë elementare për fëmijët tanë.

znj. Kadrije Lika-Troni: Këtë javë kam marrë shumë ankesa nga qytetarët lidhur me djegien e varrezave në qytet një akt i papranueshëm nga secili prej nesh. Si përfaqësuese e tyre, e ndjej obligim ta ngre këtë çështje sot. Varrezat nuk janë thjesht një hapësirë; ato janë të shenjta, një vend nderimi dhe kujtimi për të dashurit tanë që prehen aty në paqe.

Djegia e tyre nuk është pastrim, por rrezik për sigurinë publike dhe fyerje e thellë për qytetarët. Në mbledhjen e fundit të KPF-së kërkoja që kjo ngjarje të futet si pikë e rendit të ditës në Kuvend, por u tha se nuk është përgjegjësi e komunës. Po e them qartë: komuna, në këtë rast, nuk mund të rrijë duarkryq. Deri tani nuk kemi parë asnjë reagim nga kryetari Besim Ilazi dhe institucionet tjera për të dënuar këtë akt të papranueshëm.

Kërkoj nga kryetari, si kryesues i Këshillit për Siguri dhe Bashkësi, që urgjentisht të mbledhë akterët institucionalë dhe të dalë me një reagim e një plan konkret për qytetarët.

Të nderuar, heshtja nuk është zgjidhje ajo është mosrespekt për qytetarët dhe dhimbjen e tyre që e përjetuan këto ditë. Ata kanë të drejtë të kërkojnë përgjegjësi dhe veprime, jo heshtje.

z. Naim Beça: Kaluam katër vite bashkë me ju. I falënderoj të gjithë ata që kanë bashkëpunuar me opozitën dhe veçanërisht ata që kanë bashkëpunuar me mua. Kam një kërkesë lidhur me pyetjet dhe përgjigjet: besoj se në të ardhmen duhet të jenë më të shpejta për asamblistët dhe jo të presim një muaj për t'i marrë përgjigjet.

Sot nuk kam ndonjë kërkesë tjetër, sepse jemi në kohë zgjedhjesh, por desha thjesht t'ju falënderoj të gjithëve dhe t'ju uroj mirupafshim në Kuvendin e ardhshëm.

znj. Ardita Rrahmani: Nuk kam kërkesë, sepse kërkesat e mia kanë përfunduar që në korrik. Por, duke pasur parasysh situatën në të cilën ndodhemi, e ndjej për obligim të falënderoj secilin anëtar të Kuvendit Komunal për katër vite bashkëpunim.

Faleminderit, kryesues. Faleminderit edhe ju, kryetar të paktën ju jeni thirrur kuadër. Kemi pasur momente të rralla kur kemi dalë edhe prej vetes, dhe u kërkoj falje kolegëve nëse ndonjëherë nuk jemi mirëkuptuar mes vete.

Jemi thirrur për t'i paraqitur kërkesat e qytetarëve, dhe shpresoj që në mandatin e ardhshëm, kushdo që do të ketë fatin të vazhdojë, të punojë në interes të secilit qytetar. Jam e bindur që secili asamblist ka bërë më të mirën e mundshme prej vetes për qytetin tonë.

2. Propozim Vendimi për Buxhetin e Komunës së Kaçanikut për vitin fiskal 2026 dhe vlerësimet për vitet 2027-2028;

Kryesuesi i Kuvendit: Bordi i Asociacionit të Komunave të Kosovës ka njoftuar se miratimi i projekt-buxheteve komunale mund të shtyhet për një afat të pacaktuar, ose pas mbajtjes së zgjedhjeve. Kjo kërkesë i është adresuar Ministrisë së Financave, mirëpo deri më tani ministria nuk ka kthyer asnjë përgjigje zyrtare.

Megjithatë, duke pasur parasysh që Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë përcakton qartë se buxhetet komunale duhet të miratohen më së voni në fillim të muajit shtator, respektivisht deri më 30 shtator, atëherë konstatojmë se jemi ende brenda afateve ligjore për miratimin e projekt-buxhetit. Sipas të gjitha gjasave, kjo shtyrje është

propozuar për shkak se disa komuna nuk e kanë përgatitur projekt-buxhetin me kohë dhe ka pasur ngecje në proces. Tani, e hapim diskutimin për këtë pikë të rendit të ditës.

z.Valdrin Dogani: Buxheti i Komunës së Kaçanikut për vitin fiskal 2026 është në shumën prej 13,399,753.00 €, ndërsa për vitet 2027 dhe 2028, vlerësimet e parashikuara janë si vijon: për vitin fiskal 2027 në shumën prej 14,070,440.00 € dhe për vitin fiskal 2028 në shumën prej 14,757,058.00 €.

Në strukturën e të hyrave buxhetore për vitin fiskal 2026, mjetet nga grantet qeveritare janë në shumën prej 12,334,620.00 €, që përbëjnë 92.05% të totalit, ndërsa të hyrat vetanake komunale arrijnë shumën prej 1,065,133.00 €, me pjesëmarrje prej 7.95% në strukturën e përgjithshme të buxhetit.

Shpenzimet e përgjithshme buxhetore për vitin fiskal 2026 parashikohen të jenë: Shpenzime operative në shumën prej 10,192,442.00 €, Investime kapitale në shumën prej 3,207,311.00 €. Shpenzimet buxhetore për vitin 2026, sipas kategorive ekonomike, janë parashikuar me këtë ndarje, në përputhje të plotë me Qarkoren Buxhetore 2026/02, të datës 21.08.2025, të nxjerrë nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT): Paga dhe shtesa: 7,883,305.00 € (58.83%), Mallra dhe shërbime: 1,469,980.00 € (10.97%), Shpenzime komunale: 225,000.00 € (1.68%), Subvencione dhe transfere: 614,157.00 € (4.58%), Investime kapitale: 3,207,311.00 € (23.94%).

znj. Ardita Rrahmani: Jemi këtu për të diskutuar propozim-buxhetin për vitin e ardhshëm. Ky dokument përcakton se si do të menaxhohen taksat e qytetarëve tanë, si do të zhvillohet komuna dhe cilat prioritetë do të kenë institucionet tona lokale.

Fatkeqësisht, ajo që shohim para nesh nuk është një buxhet zhvillimor i komunës, por një dokument që tregon qartë dështimin e pushtetit lokal. Le t'i kujtojmë qytetarëve tanë se gjatë fushatës elektorale janë dhënë 94 premtime; sot, pas disa vitesh qeverisje, vetëm 40 janë përmbushur, ndërsa pjesa tjetër ka mbetur ose në letër ose është harruar krejtësisht.

Edhe ky propozim-buxhet i ri nuk ofron asnjë garanci se premtimet e tjera do të përmbushen. Ku janë investimet e premtuara për infrastrukturën? Rugët brenda qytetit, dhe sidomos ato të fshatrave, janë në gjendje jo të mirë. Ku janë projektet për ujësjellës dhe kanalizime, ku edhe sot kemi familje që vuajnë për ujë të pijshëm? Ku janë investimet për rininë dhe sportin, ku shumë të rinj të Kaçanikut janë të detyruar të largohen për shkak të mungesës së perspektivës? Ku është përkujdesja ndaj arsimit dhe shëndetësisë, kur shkollat tona kanë mungesa elementare, përfshirë objektet infrastrukturore?

Ky buxhet është ndërtuar krejt për interesa të ngushta, jo për qytetarët. Investimet nuk shpërndahen drejt, por përqendrohen aty ku sjellin përfitim elektorale. Si opozitë, nuk mund të mbështes një buxhet që dështon dhe nuk i përgjigjet nevojave të qytetarëve. Përkundrazi, kërkoj që prioritetet të ndryshojnë: Shërbime bazike për qytetarët: ujësjellës, kanalizim dhe menaxhim modern i mbeturinave. Investime serioze në arsim: renovim dhe ndërtim të shkollave. Shëndetësi lokale funksionale theksoj se falënderoj QKMF-në dhe punëtorët e saj për shërbimet që ofrojnë. Mbështetje për bujqësinë dhe bizneset e vogla, që janë gjeneratorët kryesorë të ekonomisë lokale. Transparencë dhe llogaridhënie: çdo projekt, çdo tender dhe çdo shpenzim i komunës duhet të jetë i hapur për publikun.

Kaçaniku nuk ka nevojë për buxhet që shërben për fasadë, por për buxhet që i kthen jetën komunës, ndalon ikjen e të rinjve dhe vendos qytetarin në qendër. Pushteti lokal duhet të dijë që qytetarët kanë memorie dhe mbajnë mend. Si opozitë, jemi këtu për të mbrojtur këto interesa.

Dje, në diskutimin buxhetor, për fat të keq pati pak lavdata dhe pak propozime. Shpresoj që ato të jenë marrë parasysh. Si LDK, jemi kundër shpërndarjes së këtij buxheti.

znj.Arlinda Raka: Kur flasim për planifikimin buxhetor, duket qartë se janë vendosur vetëm tituj projektsh pa mjete për realizimin e tyre. Qytetarët kanë nevojë për vepra konkrete, jo

vetëm për premtime. Si opozitë, kemi përgjegjësi të theksojmë se ky buxhet nuk i përgjigjet nevojave të komunës sonë dhe nuk garanton zhvillimin e saj.

z.Agim Mani: Sot jemi përballë një vendimi të rëndësishëm për qytetarët tanë: miratimi i buxhetit komunal për vitin 2026 dhe vlerësimet për 2027–2028. Si opozitë, kemi obligim moral dhe politik që këtë buxhet ta shqyrtojmë me vëmendje, ta kritikojmë aty ku është i mangët dhe ta kundërshtojmë aty ku nuk i shërben interesave të qytetarëve.

Ky buxhet që po na prezantohet sot, për fat të keq, është më shumë një buxhet elektoral sesa një buxhet serioz zhvillimor. Ai nuk është ndërtuar mbi prioritetet reale të qytetarëve apo mbi nevojat e përditshme të tyre, por mbi interesat afatshkurtra politike. E kemi parë në të kaluarën se si janë miratuar buxhetet dhe si janë realizuar: ka pasur keqplanifikime, rialokime dhe transfere të shpeshta të mjeteve nga një kategori në tjetrën, mosrealizim të projekteve të planifikuara, teprica buxhetore mbi 1 milion euro thuajse çdo vit. Kjo tregon se mjetet nuk kanë shkuar aty ku duhet dhe qytetari nuk ka marrë shërbimin e duhur.

Edhe këtë vit, ndarja e buxhetit nuk është bërë në mënyrë që qytetari të përfitojë. Fatmirësisht, buxheti për vitin 2026 është buxheti më i madh që ka pasur Komuna e Kaçanikut, por, fatkeqësisht, ka një rënie të dukshme të investimeve kapitale, aty ku qytetari pret përmirësime infrastrukturore, shërbime publike dhe zhvillim ekonomik.

Mendoj se edhe kategorizimi i buxhetit nuk është i drejtë. Për shembull, shpenzimet për mallrat dhe shërbimet janë të larta, ndërkohë që duhet të ketë kursim në këtë kategori dhe të rriten subvencionet për fermerët, blegtorinë dhe veprimtaritë e tjera. Po ashtu, mungon transparencë në ndarjen e buxhetit; ndarja e tij nuk është e qartë dhe investimet kapitale janë të përgjithshme, pa specifikuar qartë projekte si asfaltimi i rrugëve lokale dhe rurale, duke mos treguar se cilat fshatra, lagje ose segmente të rrugëve përfitojnë. Kjo lë hapësirë për keqmenaxhim dhe orientim të projekteve sipas interesave të ekzekutivit. Specifikimi i projekteve rrit transparencën dhe besimin tek qytetari.

Po ashtu, disa premtime buxhetore janë të përsëritura nga vitet paraprake ose nga viti 2025, që nuk janë realizuar. Për shembull: Ndërtimi i urës mbi lumin Lepenc, për të cilin janë ndarë 200.000-euro për vitin 2026 dhe gjithashtu 200.000-euro në vitin 2025, nuk është realizuar. Për asfaltimin e rrugës Hamez Jashari, janë ndarë 50.000-euro për vitin 2025, por nuk është realizuar. Ndërtimi i aneksit të shkollës “Feriz Guri dhe Vëllezërit Qaka” ka pasur një buxhet të ndarë prej 200.000 eurosh për vitin 2025 dhe 2026, por nuk është realizuar.

Kjo tregon keqplanifikim dhe mungesë të një kodi të ri buxhetor që reflekton nevojat reale të qytetarëve. Qytetarët e Kaçanikut kanë nevojë për një buxhet që i përmbush kërkesat e tyre reale, jo vetëm shifra në tabela, me më shumë investime infrastrukturore dhe transparencë.

Siç shihet në tabelat e investimeve kapitale, edhe për vitin 2026 qytetarët do të mbeten pa ujë, pa energji, pa infrastrukturë. Megjithatë, ne kemi disa kërkesa të qytetarëve, të cilat do t'i citojmë më vonë. Me këtë plan buxhetor që keni sjellë në Kuvend, ne do të jemi kundër. Përndryshe, nëse realizohen kërkesat e qytetarëve, do t'i citojmë tani me radhë.

znj.Ernesta Krasniqi: Një prej problemeve më kryesore që kam pas edhe në Kuvend është mungesa e ujit, dhe sipas buxhetit shohim se vetëm 52.000 euro keni ndarë për vitin 2026 për me nxjerr njëherë e përgjithmonë problemin e ujit. Për vitin 2027 keni ndarë 150.000 euro dhe 200.000 euro për vitin 2028.

Unë propozoj që 400.000-euro të ndahen për vitin 2026, sepse nuk është një problem që mund të zgjidhet vetëm me 52.000 euro. Ky nuk është problem vetëm i Kaçanikut dhe Dubravës, por edhe i Nikajt dhe Kaçanikut të Vjetër.

52.000-euro nuk e di se cilës lagjeje do t'i mbulojnë për të zgjidhur këtë problem uji.

Dy emërtimet përgjithshme, prapa të cilave po shikoni dhe po abuzoni me buxhetin komunal, janë rregullimi i rrugëve urbane dhe rregullimi i rrugëve lokale rurale. Këto duhet të specifikohen mirë, se cilat rrugë do të investohen. Duhet të kenë emërtime të veçanta për çdo

rrugë, dhe jo vetëm të vendoset një shifër pa e ditur se cilat rrugë në të ardhmen presim të investohen.

Për shembull, rregullimi i rrugëve urbane: Rruga Ekrem Gudaqi ka nevojë për investim, rruga e fshatit Provli ka nevojë për investim, rruga Osman Luma gjithashtu ka nevojë për investim. Në qytet kemi një rrugë kryesore me kalldrëm, dhe kam bërë pyetje disa herë për gjendjen e saj, por nuk kam marrë përgjigje. Tash dua të di se nga e mbani për të ardhur në punë? A e mbani nga rruga me kalldrëm? Gjendja është skandaloze. Rruga Tefik Raka dhe rruga mahalla Sheler.

Propozimet tjera që mendoj se janë të nevojshme për rini janë: një teren sportiv me bari sintetik në fshatin Begrac, Kaçanik Vjetër dhe Dubrav, sepse nuk kemi asnjë teren sportiv me bari sintetik në fshatra.

Fushat tani keni filluar t'i shtroni edhe oborret me asfalt, duke abuzuar me buxhetin komunal, por më tepër e keni bërë në komunën e Kaçanikut lypësar. Po kërkon para nëpër fshatra për të lyer shkollën në Nikaj, për të rrafshuar dhe mirëmbajtur një pjesë të Kaçanikut të Vjetër, dhe prap po abuzoni me këto para. Po mblidhni dhe po abuzoni me para sepse ju duhen për fushat. Nëse këto propozime tona nuk futen në buxhet, grupi parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosjes është kundër.

z.Naim Beça: Pika 27 thotë: ndërtimi i shtretërve të lumenjve dhe përrojeve në Stagov, Kaçanik Vjetër, Bob, Kovaqec, Biqec dhe Dubrav.

Edhe Kaçaniku ka perrocka, ndërsa Kovaqeci është pastruar mbi 10 herë, por Kaçaniku nuk është pastruar asnjëherë. Përrocet e Mahallës Rakoc, edhe në seancën e parë, kam bërë projekt për pastrimin e tyre, por nuk ka pasur interes nga askush. Pse nuk ka perrocka në fshatin Krivanjev? Ato janë zhdukur krejtësisht. Më së shumti banorë që kanë qasje në perrocka kanë në dispozicion perrocken e Rakocit, dhe as ky nuk është përfshirë për t'u pastruar.

A ka mundësi të shpjegohet pse kjo nuk është përfshirë në plan?

Andaj, e them me përgjegjësi të plotë: jam kundër këtij buxheti. Ky buxhet është i njëanshëm.

z.Valdrin Dogani: Emërtimi është kështu dhe është projekt aktual, por kemi buxhet për vitin e ardhshëm.

z.Agim Çaka: Unë nuk dua të hy në detaje për përfshirjen e projekteve në buxhet, por do të jap mendimin tim rreth shpenzimit të buxhetit për këto vite, dmth për mandatin tonë.

Përkundër se gjatë këtyre viteve kemi ngritur çështjen e buxhetit, gjendja e infrastrukturës në komunën tonë nuk është e kënaqshme. Ende kemi probleme me ujë të pijshëm, ndriçim publik, rrugë, kanalizime, mungesë investimesh kapitale dhe zhvillim ekonomik. Si pasojë e këtyre mangësive, komunën tonë e karakterizon zvogëlimi i popullsisë dhe i numrit të qytetarëve. Edhe gjatë këtij mandati ka rënë numri i asambleistëve, gjë që reflekton largimin e qytetarëve, jo për shkak të luksit, por për shkak të kushteve të këqija dhe mungesës së investimeve.

Menaxhimi i buxhetit në komunë ndër vite nuk ka qenë në përputhje me interesat e qytetarëve dhe nuk ka plotësuar pritshmëritë e tyre. Duhet thënë qartë se ajo që shkruhet në letër nuk përputhet me gjendjen në terren. Në letra nuk shihen humbjet e parave, por shpenzimi i mjeteve dhe situata reale në terren tregojnë një disproporcion të madh mes asaj që shkruhet në dokumente dhe asaj që ndodh në fakt. Kur diskutojmë për tabela dhe shifra, ato duken të sakta, por kur ndalem te shpenzimi i këtyre mjeteve në terren, situata tregon krejt diçka tjetër. Këtu nuk jemi vetëm ne që e shohim këtë, por edhe qytetarët dhe mediat. Unë ndihem keq që kam qenë pjesë e këtij mandati dhe nuk kam pasur mundësi të veprojmë shumë, të parandalojmë keqmenaxhimin e komunës ose të ndikojmë për përmirësimin e situatës.

znj.Arlinda Raka: Një sqarim: për renovimin e QKMF-së janë ndarë 50,000 euro, mirëpo e di që është objekt i ri dhe nuk besoj se ka nevojë për renovime.

z.Bashkim Krasniqi: Së pari, më vjen mirë që të gjithë jemi këtu dhe seanca nuk është lëshuar. Më pëlqen që po debatoni kërkesat; kjo është pozitive, por më duket pak si po afron fundi. Sa i përket premtimeve të realizuara, është mirë të cekim që premtimet që nuk janë realizuar lidhen kryesisht me grantin e katërt qeverisës, i cili kurrë nuk ka ardhur. Këto premtime janë të arsyeshme, pasi ato nuk mund të realizoheshin pa grantin. Sa i përket menaxhimit të taksave, qytetarët e kanë vendosur dhe menaxhuar taksat e tyre, i kanë besuar dikujt dhe ai ka përmbushur premtime që janë realizuar rreth 90%. Sa i përket transparencës, komuna jonë është e para për transparencë, dhe këtë nuk po e them unë, por është dokument. Sa i përket buxhetit elektorale, a ka mundësi të na tregoni ku ndodhet dhe cilat investime janë pjesë e tij? Ndërsa në bujqësi, investimet dhe grantet, mendoj se gjatë këtyre katër viteve bujqësia ka qenë një nga drejtori që ka investuar më së shumti.

znj.Ardita Rrahmani: Në dëgjimin buxhetor që ka qenë dje, i nderuari koleg nuk ka qenë prezent, por ka qenë dashur me ardh në dëgjimin buxhetor kur i dhashë propozimet e mia. Kam pritur mbrëmë emailin me ato propozime, të cilat u diskutuan në prezencë të kryetarit. Kryetari tha se është një propozim i drejtë. Njëri nga propozimet e mia konkrete, që çdo vit i bëj, ka qenë zgjerimi i parkingut të varrezave të qytetit. Kryetari në dëgjimin buxhetor dje tha se është një propozim i drejtë dhe që do të realizohet. Megjithatë, kam pritur 24 orë për emailin me këtë ndryshim, por nuk ka ardhur asgjë. Sa i përket bujqësisë në Kaçanik, është e qartë që duhet të ketë një orientim më të madh dhe që investimet më të mëdha të bëhen në këtë sektor. Propozimet tona si LDK janë të njohura dhe qytetarët e dinë që nuk ka pasur asnjë seancë buxhetore në katër vitet e fundit ku propozimet tona të jenë marrë parasysh. Ne kemi lëshuar sallën për diskutime, kemi qëndruar këtu dhe kemi dhënë propozimet tona, por ato nuk kanë kaluar, edhe pse kemi pasur të drejtën e votës.

z.Besim Ilazi: Fillimisht, meqenëse është seanca e fundit, dua t'ju falënderoj secilin veç e veç, duke filluar nga kryesuesi dhe ju asamblistët, pozitë e opozitë për kritikën, vërejtjet dhe sugjerimet. Është e vërtetë që kemi pasur edhe tensione brenda situatës, por besoj se qëllimin e kemi pasur gjithmonë të mirë. Shpresoj dhe besoj që këtë ta bëjnë edhe në të ardhmen asamblistët e rinj që do të vijnë. Megjithatë, fjala falënderuese nuk është formale po e them shumë drejt: kam qenë gjithmonë falënderuese, përkundër gjithçkaje, sepse kemi pasur një bashkëpunim jashtëzakonisht të mirë. Edhe përkundër tensioneve e situatave, kemi arritur t'i menaxhojmë ato me maturi. A kam qenë i përkryer, a kam pasur gabime nuk e kontestoj asnjëherë, sepse jemi njerëz dhe gabojmë në momente të caktuara, në kohë të caktuara, në projekte apo në çdo gjë tjetër. Megjithatë, sot është dita e fundit që takohemi në këtë seancë, prandaj e shfrytëzoj rastin edhe njëherë për një falënderim të veçantë për secilin veç e veç. Shpresoj dhe besoj që të bëjmë më të mirën e mundshme dhe uroj që fushata të jetë ashtu siç kemi qenë këtu me synimin për të arritur qëllimin që e kemi. Vota e qytetarit do ta vlerësojë më së miri se kush do të jetë. Meqenëse jemi te buxheti, e kemi para jush dhe para nesh realizimin e tij. Disa kritika e vërejtje që u thanë nuk po them që është buxhet i përkryer dhe as që i përmbush plotësisht kërkesat e qytetarëve. E dimë të gjithë se cili buxhet do t'i përmbushte plotësisht ato kërkesa. Nuk kam thënë asnjëherë që s'kemi pasur gabime në cilësi apo në menaxhimin e projekteve. Megjithatë, insistimi ynë ka qenë të arrijmë më të mirën e mundshme, pavarësisht defekteve dhe lëshimeve që kemi pasur. Në fund, qytetari do të na vlerësojë qofshim pozitë apo opozitë dhe do ta pranojmë vendimin e tij. Do të ndalem në disa elemente që dua t'i sqaroj, sepse disa nga vërejtjet nuk janë krejtësisht të sakta. U tha se buxheti është më i madh dhe po, është e vërtetë por pse është zvogëluar paraprakisht, e sqaroj edhe drejtori: buxheti është rritur për 800 mijë euro, por mbi 1 milion euro shkojnë vetëm për paga, dhe këtu qëndron ajo "ramja". Nganjëherë bie ndesh edhe mes asamblistëve dikush kërkon ta zvogëlojmë mirëmbajtjen dhe shpenzimet për mallra, ndërsa dikush kërkon t'i rrisim. Faktikisht, nëse mund t'i zvogëlojmë është mirë, por edhe nëse mund t'i rrisim, është po aq e arsyeshme. U përmendën subvencionet. E di që numri i tyre as këtë herë nuk është i

mjaftueshëm për nevojat e qytetarëve, bizneseve dhe fermerëve, por megjithatë, për fat të mirë, këtë herë kemi pasur më shumë. Për katër vjet kemi sjellë trefish më shumë subvencione sesa kishim planifikuar fillimisht. Shpresoj që me angazhimin e përbashkët të ekzekutivit dhe zyrtarëve, të vazhdohet në të njëjtin trend dhe të arrihet tërheqja e fondeve përmes organizatave të ndryshme. Sa i përket asaj që përmendi Ardita nuk desha të pajtohem me ty sepse nuk është reale. Dua t'i bind të gjithë se nuk është e vërtetë që mungon transparenca apo që premtimet nuk janë përmbushur. Në fund, e kam të shënuar në fusnotë pse disa projekte janë të tilla: ato janë projekte të cilat i kemi parashikuar në bazë të grantit të katërt, i cili nuk është realizuar asnjëherë. Për këtë arsye, ka qenë fat dhe kujdes nga ana jonë që t'i lëmë me fusnotë, nëse këto premtime realizohen nga niveli qendror. Dhe shpresojmë që do të realizohen. Edhe pa to, ne kemi arritur të realizojmë disa projekte jo të gjitha, por një pjesë të mirë.

Sa i përket ujësjellësit, po e them shumë drejt: kemi lënë kod dhe mjete për burime të ujit të mjaftueshme. Këto mjete janë zakonisht për infrastrukturë, mirëmbajtje dhe gypa. Prej tre vitesh nuk e menaxhojmë më ne, dhe kjo është debatuar edhe në Kuvend e do të debatohet sërish në të ardhmen. Por, për burimet e ujit, Kaçaniku nuk duhet të mbetet pa ujë në verë. Mund të ketë reduktime të vogla, por burimet e ujit janë të mjaftueshme sipas kapaciteteve dhe matjeve që bëjnë vetë kompanitë. Arsyeja kryesore pse ka mungesa është për shkak të humbjeve të mëdha të ujit. Nuk dua të akuzoj askënd, por kjo është arsyeja. Përndryshe, edhe sot kemi 7 puse që nuk shfrytëzohen 2 në Kaçanik të Vjetër, 2 në Koxhaj, 1 në qytet, 2 te Saniteksi dhe një te Uji i Nxehtë. Këto janë burime që mund të shfrytëzohen në të ardhmen.

Sa i përket kodeve dhe përrockave Naim, vetëm një korrigjim: në pikën 27 nuk është "pastrimi i perrockave", por "rregullimi i perrockave të reja". Ndërsa përroni i Rakocit dhe ai i Krivanjevës janë pastruar vitin e kaluar. Te kodet për rrugë lokale dhe urbane nuk kam ndonjë brengë, sepse tashmë jemi në fazën kur rrugët e gjata pothuajse janë realizuar. Rrugët e mbetura janë me gjatësi të shkurtër 20, 30 metra dhe fatmirësisht kemi arritur deri te këto pjesë. Ato më të gjatat do të trajtohen me kode të veçanta, ashtu siç kemi bërë më herët. U përmendën edhe rrugët me kalldrëm po, është e vërtetë që janë dëmtuar kohëve të fundit, kryesisht për shkak të mbylljes së magjistrales për 6 muaj. Ne kemi vendosur shenjë që ndalon qarkullimin e mjeteve të rënda mbi tonazh, por përkundër insistimit tonë me zyrtarët, nuk kemi mundur asnjëherë t'i ndalim plotësisht. Sa i përket rrugëve lokale, përruave dhe kanalizimeve nuk mund t'i përmendim me emra, sepse ndërhyrjet bëhen në bazë të kërkesave zyrtare dhe zakonisht janë në pjesë të vogla. Sa kemi mundur, i kemi realizuar. Dhe, në krahasim me kërkesat e qytetarëve, jam mundur që buxhetin ta bëj sa më përpiktë, duke marrë parasysh debatet e vazhdueshme me qytetarët dhe administratorët që kanë ngritur shqetësime nëpër fshatra. Ata kanë pasur shumë kërkesa, por sa kemi pasur mundësi, i kemi përfshirë në buxhetin e ardhshëm, me shpresë që ai do të jetë më i madh dhe që edhe niveli qendror do të reflektojë e të sjellim më shumë investime në Komunën e Kaçanikut, të cilat kanë munguar për katër vitet e fundit. Në fund, vërejtja ime kryesore mbetet cilësia e punës dhe menaxhimit, ku kam parë një mangësi që më ka shqetësuar gjithmonë. Kam insistuar shumë, edhe pse nuk kam arritur gjithmonë aty ku kam dashur.

znj. Ernesta Krasniqi: Ndertimi i fabrikës për trajtimin e ujit të pijes në Sepetin, me kosto 2000 euro, kjo është hajgare. Në vitin 2021, kur dole prej mbledhjes në seancën e fundit, ndërtimi i fabrikës për ty ka qenë projekt kryesor gjatë mandatit të ardhshëm. Kanë kaluar 4 vjet, ku është investimi? Sa i përket rrugës me kalldrëm që the se nuk mundesh me i ndaluar, a keni kompetenca? A keni bashkëpunim? Dënon, nuk guxon më me shku andej.

z.Besim Ilazi: Sa i përket fabrikës, e kam përmendur me fusnotë dhe pyet kryeshefin ekzekutiv të Bifurkacionit për premtimin që është dhënë, se në vitin 2028 sigurt do të realizohet nga qeveria. Ju jeni dëshmitar të fjalës së dhënë.

Kurse për ata për të cilët nuk kam pasur mundësi dhe nuk mund ta bëj, e kam marrë vetëm si kod; për këtë e kam vendosur me fusnotë, sepse ka një kosto që kam problem ta përballoj.

Kryesuesi i Kuvendit: Ndërtimi i fabrikës së ujit dihet sa është kostoja e lartë. Na duhet të bëjmë buxhetin për tre vite për të ndërtuar fabrikën e ujit.

z.Rrustem Zenuni: Unë, si asambleist dhe si qytetar, gjithmonë kam tentuar të kuptoj kapacitetet që i ka pasur komuna, por edhe të tjerët që kanë mundur, po nuk ka pasur mundësi. Buxheti duhet të shpërndahet jo për vota apo për elektorat, por sipas nevojës së qytetarëve të komunës tonë.

U përmend që nuk ka pasur terrene sportive, por në fillim të vitit 2024 komuna i ka futur në listën e projekteve që i ka dërguar në ministri. Konkretisht, po flas për projektin e fushës sportive në fshatin Duraje; e kemi dërguar në ministri, por nuk kemi marrë asnjë përgjigje. Ne, si Partia Demokratike, jemi pro zhvillimit të komunës tonë dhe mbështesim çdo projekt, pavarësisht nëse është në lokalitetin tim apo jo, sepse qytetari nuk ndahet.

z.Qamil Stagova: Sa i përket investimeve kapitale, konkretisht të planifikimi urban i mjedisit, në numër 22 është ndërtimi i trotuarit në rrugën Reshat Shehu. Këtu është parapa për rrugë dhe trotuar, që mund të përfshijë edhe përrocken e Rakovcit. Pra, investimet janë të planifikuara: 200,000-euro për vitin 2026. Normalisht, edhe për vitin 2025 kanë qenë të planifikuara, por nuk u realizuan për shkak të kontratës kolektive.

z.Agim Mani: I kam thënë edhe disa kushte që mund ta përkrahim këtë projekt-buxhet për interesat e qytetarëve. Kryetari tha se burimet e ujit janë të mjaftueshme, mirëpo nuk ka seriozitet për të zgjidhur problemin e qytetarëve. Mendoni ta zgjidhni problemin me vetëm 52,000-euro për vitin 2026, ndërkohë që e dimë që kjo nuk është e mjaftueshme. Ne propozojmë që të ndahen 400,000-euro për vitin 2026, për të zgjidhur problemin e ujit dhe që në vitin 2027 të mos ketë më problem me ujë.

Edhe pse mund të mbeten disa projekte të tjera, uji është prioritar. Kërkojmë që në vitin 2026 të ndahen 400,000-euro dhe të rregullohet plotësisht infrastruktura ku ka nevojë, të blihen pompat për pusët që kanë ujë të mjaftueshëm dhe të jenë funksionale, në mënyrë që problemi i ujit të zgjidhet. Nga kjo shihet qartë se ekzekutivi nuk e ka në plan të zgjidhë këtë problem as në vitin 2026, as në vitin 2027, por vetëm e lë si plan të vazhdueshëm si deri tani, duke i hedhur fajin dikujt tjetër. Mirëpo, fajin nuk duhet ta kërkojmë tek të tjerët; pyetja është e qartë: a doni të zgjidhni problemin e ujit apo jo? Nëse doni, ndani 400,000-euro dhe qytetarët do të kenë ujë të mjaftueshëm. Nëse nuk i ndani, qytetarët do të vazhdojnë të përballen me mungesën e ujit.

z.Selajdin Troni: Një falënderim i veçantë për kryetarin, nënkryetarin dhe drejtorin, të cilët kanë realizuar një investim të bukur në Rrugën e Lirisë, pjesa e Ram Bujes. Është bërë një punë e jashtëzakonshme, dhe janë përfshirë të gjithë poligonet e djemve dhe vajzave që kanë dhënë kontributin e tyre. Ky është një nga investimet më të mira, dhe besoj që buxheti që po votojmë për vitin 2026 të jetë buxhet pune, që të përcillen dhe realizohen sa më mirë të gjitha projektet.

Kryesuesi i Kuvendit: Pika e parë është që me një investim prej 400,000 euro, kush është i sigurt se do të zgjidhet problemi i ujit në Kaçanik? A është i sigurt dikush se çështja me 50,000 euro është e mjaftueshme? Është sqaruar që kjo shumë është vetëm për mirëmbajtje, ndërsa vlera që duhet të investohet vetëm në ujësjellësin e Kaçanikut është mbi 3 milion euro, dhe ky investim duhet të realizohet nga niveli qendror përmes kompanive rajonale.

Duhet të kemi të qarta të gjitha elementet dhe të mos e politizojmë këtë çështje jetike për qytetarët në Kuvend. Vijat e diskutimit dhe të investimit duhet të jenë të qarta: komuna mund të ofrojë mundësi logjistike dhe të mirëmbajtjes, por vlera e investimit duhet të bjerë tek ai që merr inkasimin, që qytetarët të mos paguajnë për ujë dhe përgjegjësia të mbahet aty ku duhet.

Diskutime të tjera nuk ka, atëherë këtë pikë e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua me 14 votë Për, Kundër 9. Abstenim 2 . Prezentë 25. Në sajë të kësaj del konstatimi se Kuvendi i komunës mori këtë:

VENDIM

Për Miratimin e Buxhetit të Komunës së Kaçanikut, për vitin fiskal 2026 dhe vlerësimet për vitet 2027-2028/ Lënda: 01Nr. 400/01-21750/25.

3. Propozim Vendimi për miratimin e Planit Ndërkomunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave për rajonin e Gjilanit dhe Ferizajt (2025-2030);

Kryesuesi i Kuvendit: Këtë vendim e kemi trajtuar njëherë dhe e kemi shfuqizuar si vendim, dhe është rregulluar siç është kërkuar. Tani ka ardhur prapë për votim në Kuvend. Nëse ka dikush, urdhëroni këta e kanë bërë të gjitha komunat që janë në rajonin e Ferizajt dhe Gjilanit.

z.Agim Mani: Këtë propozim vendim për miratimin e Planit Ndërkomunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave për rajonin e Gjilanit dhe Ferizajt (2025-2030), kemi pasur edhe herën e kaluar, më 27.02.2025, dhe e kemi kaluar, ne i kemi dhënë votën për. Ju e dini që mosserioziteti i ekzekutivit, veçanërisht i ish-drejtorit të shërbimeve publike, i cili nuk e ka harmonizuar mirë këtë vendim, çoi deri te shfuqizimi më 30.05.2025.

Mirëpo, datën e shfuqizimit që e keni sjellë ju në Kuvend, unë ju kam thënë se si shfuqizim nuk është i drejtë, dhe prapë e keni sjellë të njëjtën këtu. Nëse dikush mundet, me këtë dokument mund të shfuqizohet ky vendim. Nëse e keni analizuar dhe shqyrtuar, është absurde siç e kam thënë edhe më parë, nuk e keni shqyrtuar aspak dhe e keni sjellë të njëjtën me gabime teknike, për të cilën keni marrë vendim.

Nëse nuk e keni shfuqizuar këtë vendim, nuk mund të merrni vendim të njëjtin përsëri.

Kryesuesi i Kuvendit: Është shfuqizuar vendimi.

z.Agim Mani: Cili vendim është shfuqizuar?

Kryesuesi i Kuvendit: Është shfuqizuar vendimi që kemi marrë më herët, po ua kaloj fjalën drejtorit të shërbimeve publike, sepse ai është më i informuar.

z.Arian Teneqja: Plani ndërkomunal për menaxhimin e integruar të mbeturinave është një dokument i hartuar nga kompani konsulente, ekspertë të fushës GIZ. Ky dokument është përgatitur me pjesëmarrjen e zyrtarëve të komunave përkatëse dhe është kthyer nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për shkak të vendimit për pëlqim mjedisor, i cili është marrë.

Dokumenti konstaton që janë ofruar të gjitha dokumentet e parapara sipas ligjit 03/230 për vlerësim mjedisor dhe komunat i kanë përmbushur të gjitha obligimet ligjore, duke përfshirë organizimin e debateve publike dhe publikimin e raporteve në faqet e internetit të komunave për komentet dhe trajtimet e komiteteve të palëve të interesit.

Prandaj, të gjitha komunat e tjera e kanë miratuar këtë plan, dhe kërkoj nga ju që të votohet përsëri.

z.Agim Mani: Ne nuk jemi kundër planit, por jemi kundër procedurave që po na sjellin me gabime. Shihni se çfarë na keni sjellë në Kuvend. E di që për procedurat paraprase nuk keni qenë drejtor, por unë edhe atëherë i kam kontestuar procedurat. Megjithatë, ekzekutivi nuk ka marrë asnjë hap në këtë drejtim.

z.Arian Teneqja: Unë po flas për gjendjen e tanishme të planit; ai i ka përmbushur të gjitha kriteret.

z.Agim Mani: Po tash nuk jam i sigurt nëse vendimi është shfuqizuar apo jo. Nëse është shfuqizuar me këtë dokument, atëherë është gabim.

Kryesuesi i Kuvendit: Agim, si nuk je i sigurt? Ky vendim është shfuqizuar në këtë Kuvend.

z.Agim Mani: Kryesues, nuk e ke sjellë të përmirësuar. Shiko çfarë ke sjellë në Kuvend, a e kupton çfarë ke sjellë? Vendimi për miratimin e Planit Ndërkomunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave nga Kuvendi Komunal, i datës 27.02.2025, është kthyer nga Ministria. I nderuar Kryetar z. Ilzi dhe Kryesues z. Murseli, Ministria e Planifikimit Hapsinor dhe Infrastruktures, në pajtim me Rregulloren dhe ndryshimin e plotësimit të Rregullores, nenit 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve komunale, ka dhënë përgjigje më 7/3. Por nuk bëhet fjalë për këtë datë 2025; Ministria e MAPL-së ka pranuar vendimin 01Nr60/01-31476/2024, të datës 24/12/2024.

Numri i lëndës është 01Nr60/01-31476/2024. Ky vendim është krejt tjetër. Nëse e ke këtë dokument para edhe më herët, të kam thënë se me këtë shkresë shfuqizohen dy vendime. Ka edhe një vendim tjetër që e kemi marrë për mbeturina inerte.

Kryesuesi i Kuvendit: Tjetër vendim është ai për mbeturinat inerte. Vendimi për mbeturinat inerte, me të cilin është caktuar lokacioni, lidhet me Planin e Menaxhimit të Integruar të Mbeturinave në rajonin e Ferizajt dhe Gjilanit. Ky plan është unik për të gjithë komunat e Gjilanit dhe Ferizajt. Nuk ka lidhje me vendimin e mëparshëm.

z.Agim Mani: Po, me këtë dokument e keni shfuqizuar këtë vendim?

Kryesuesi i Kuvendit: Kjo është një rregullore, jo vendim. Çfarë ka kërkuar Ministria?

z.Agim Mani: Sipas asaj që unë lexova një herë, MAPL, me vendimin 01Nr60/01-31476/2024, të datës 24/12/2024, ka përcaktuar lokacionin për deponinë e mbeturinave inerte.

Kryesuesi i Kuvendit: Jo, Agim, ti ke një shkresë tjetër. Ndoshta ka ndodhur gabim në email, ose ti e ke marrë gabim. Ju të tjerët, a e keni marrë materialin e Kuvendit? Sepse kjo shkresë që e ka Agimi nuk është për këtë mbledhje. Diskutime të tjera nuk ka, atëherë këtë pikë e shtrojmë në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua me 17 votë Për, Kundër 1. Abstenim 7. Prezentë 25. Në sajë të kësaj del konstatimi se Kuvendi i komunës mori këtë:

VENDIM

Për miratimin e Planit Ndërkomunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave për rajonin e Gjilanit dhe Ferizajt (2025-2030)/ Lënda: 01Nr. 104/01-22117/25.

4. Kërkesa e MMPHI dhe MAPL për rishqyrtim të Rregullores për transport rrugor në territorin e komunës së Kaçanikut.

Kryesuesi i Kuvendit: Materialin e keni marrë, e hapi diskutimin.

z.Agim Mani: Desha një sqarim, a është rishqyrtim apo shfuqizim i vendimit?

Kryesuesi i Kuvendit: Është rishqyrtim.

z.Agim Mani: Ju e dini që edhe në këtë mbledhje, më 30.06.2025, e keni marrë të njëjtin vendim; ne si grup i asambleistëve jemi dakord. Mirëpo, në mbledhjen e KPF-së na ka ardhur një dokument nga Drejtori i Shërbimeve Publike, më 24.06.2025, për të plotësuar këtë rregullore në Kuvendin Komunal. KPF-ja e ka shqyrtuar dhe e ka dërguar për Kuvend. Shqyrtimi që duhej bërë ishte sipas nenit 12, për të shtuar pikat 1 dhe 1.2, te neni 59 pika 2, dhe te neni 86 të hiqet terësi pika 2. Mirëpo, kur e keni sjellë në Kuvend, e keni sjellë prapë pa

përmirësime dhe të njëjtën e keni dërguar për shqyrtim ligjor te MAPL pa përmirësime. MAPL-ja e ka kthyer, sepse sipas rregullave këto pika duhej të përmirësoheshin, të cilat ishin shqyrtuar edhe nga KPF-ja.

Kuvendi Komunal e ka votuar, por shqyrtim ligjor ka shkuar pa përmirësime. Për këtë arsye, MAPL ka kërkuar prapë rishqyrtim të këtyre pikave. Gabimi ka qenë nga ekzekutivi, i cili kur e ka dërguar për shqyrtim ligjor nuk e ka dërguar të kompletuar.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime të tjera nuk ka, atëherë këtë pikë e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua me 16 votë Për, Abstenim 9. Prezentë 25. Në sajë të kësaj del konstatimi se Kuvendi i komunës,

APROVOJ

**Rregulloren Nr.05/2025 për transport rrugor në territorin e komunës së Kaçanikut/
Lënda: 01Nr. 104/02-22066/25.**

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje, SHFUQIZOHET Rregullorja 03/2025 me numër të protokollit 01Nr.07-104/02-13623/25 e datës 30.06.2025 për Transport Rrugor në Territorin e Komunës së Kaçanikut, si dhe vendimi për miratimin e kësaj rregulloreje.

Mbledhja i përfundoj punimet në ora 13:15. Deri në fund të mbledhjes qëndruan 25 anëtarë të KK-të.

Procesmbajtës
Mavije Murseli



Kryesues i Kuvendit
Kemal Murseli

